

VENDIM
Nr. 154, datë 19.3.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 144, DATË 20.2.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PJESËMARRJEN E NJË EKIPI KËSHILLUES USHTARAK (MAT-A) TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË OPERACIONIN USHTARAK “ISAF”, NË
AFGANISTAN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14, të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit nr. 144, datë 20.2.2013 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“3. Misioni i ekipit këshillues ushtarak (MAT-A) është të asistojë dhe të këshillojë për trajnimin, drejtimin, mbështetjen dhe zhvillimin operacional të Forcave të Lëvizshme Dislokuese të Brigadës së Parë Afgane (Br1Mobil Strike Force), duke vepruar e kryer detyra operationale e luftarake në zonën e përgjegjësisë së Komandës Rajonale-Qendrore (RC-C), operacioni “ISAF”, në Kabul, Afganistan, me qëllim zhvillimin e një force të aftë, kompetente dhe profesionale.”.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e miratuara për çdo vit në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.
3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama